



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Dokument Parlamentar

RAPORT

**PËR
PROJEKTLIGJIN “KODI AJROR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”**

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë 12.09.2018, me cilësinë e **Komisionit për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “*Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë*”

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje e datës 17.07.2018 kanë qënë të pranishëm përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

1. Qëllimi i projektligjit

Qëllimi i këtij projektligji, sipas nenit 2 të tij, është rregullimi ligjor i hapësirës ajrore shqiptare dhe të marrëdhënieve juridike në fushën e transportit ajror.

2. Plani Kombëtar për Integrimin European 2018-2020

Projektligji “Kodi ajror në Republikën e Shqipërisë” është i parashikuar në **Kapitullin 14: Politika e Transportit**”.

1. ASPEKTET PROCEDURIALE TË PËRAFRIMIT

- Neni 70 i MSA-së njeh rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

2. ASPEKTET MATERIALE TË PËRAFRIMIT

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE): **Nenet 90-91** (ish-nenet 70-71 të TKE); **Neni 100, pika 2** (ish-neni 80 TKE),
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): **Kapitulli III, Ofrimi i shërbimeve, Neni 59, pika 4, 6 dhe 7.**

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- Rregullorja (KE) nr.1008/2008, e Parlamentit European dhe Këshillit, datë 24 shtator 2008, “Mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore në Komunitetin European”,
- Rregullorja (KE) Nr. 1070/2009, datë 21 tetor 2009 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 549/2004, (KE) Nr. 550/2004, (KE) Nr. 551/2004 dhe (KE) Nr. 552/2004 me qëllim përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit evropian”,
- Rregullorja (BE) Nr.996/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 tetor 2010, “Mbi investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil, e cila që shfuqizon Direktivën 94/56/EC”,
- Rregullorja (KE) Nr.300/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 mars 2008, “Për rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil, e cila shfuqizon Rregulloren (EC) nr.2320/2002”.

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me Acquis të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

3. SHQYRTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË DISPOZITAVE TË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS TË BE

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Rregulloren (KE) nr.1008/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 24 shtator 2008, “Mbi rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore në Komunitetin Evropian”, Numri CELEX 32008R1008, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, **seria L, nr.293, datë 31.10.2008, fq.3-20;**

[Type here]

- Rregulloren (KE) Nr.1070/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, që ndryshon Rregulloret **(KE)** Nr.549/2004, **(KE)** Nr.550/2004, **(KE)** Nr.551/2004 dhe **(KE)** Nr.552/2004, me qëllim përmirësimin e performancës dhe qëndrueshmërisë së sistemit të aviacionit evropian”, Numri CELEX 32009R1070, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, **seria L, nr.300, datë 14.11.2009, fq.34-50;**
- Rregulloren (BE) Nr.996/2010 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 tetor 2010, “Mbi investigimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil, e cila shfuqizon Direktivën 94/56/EC”, Numri CELEX 32010R0996, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, **seria L, nr.295, datë 12.11.2010, fq.35-50;**
- Rregulloren **(KE)** Nr.300/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 mars 2008, “Për rregullat e përgjithshme në fushën e sigurisë së aviacionit civil, e cila shfuqizon Rregulloren (KE) Nr. 2320/2002”, Numri CELEX 32008R0300, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, **seria L, nr.97, datë 09.04.2008, fq.72-84.”**

2. Pika 3 e nenit 109 të projektligjit “Raporti i investigimit” të riformulohet si vijon:

“3. Autoriteti i Investigimit, nëse është e mundur, brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data e aksidentit ose incidentit te rëndë, përgatit raportin përfundimtar të investigimit dhe rekomandimet për sigurinë”.

3. Fjalja hyrëse e pikës 1 të nenit 119 të projektligjit të riformulohet si vijon:

“1. Standardet bazë themelore për ruajtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme që rrezikojnë sigurinë aviacionit civil dhe masat e përgjithshme përfshijnë, si më poshtë:”

Komisioni, pas shqyrtimit të projektligjit, e miratoi atë me shumicë votash.

NËNKRYETARI

BLEDAR ÇUÇI